

## Procesi i Berlinit dhe Bashkëpunimi Rajonal në Ballkanin Perëndimor

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) organizoi më 10 korrik 2021, në Tiranë, Shqipëri, një tryezë të rrumbullakët për përfaqësues të lartë të partive kryesore politike nga Ballkani Perëndimor për të diskutuar të ardhmen e Procesit të Berlinit. I nisur në vitin 2014 nga kancelarja gjermane Angela Merkel, procesi synonte të rrisë bashkëpunimin rajonal dhe integrimin e rajonit në BE. Samiti i fundit i nismës shtatëvjeçare u mbajt në korrik 2021. Megjithëse ende nuk është marrë ndonjë vendim për të ardhmen e tij, pjesëmarrësit e samitit theksuan nevojën për vazhdimin e Procesit “për të shfrytëzuar potencialin e plotë të përmirësimit të bashkëpunimit rajonal.” Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Tiranë thanë se vazhdimi i procesit duhet t’iu përshtatet rrethanave të reja në rajon. Pjesëmarrësit që i njohin politikat e BE-së thanë se rajoni mbetet lartë në agjendën e BE-së, por shumë përfaqësues të Ballkanit Perëndimor ishin skeptikë. Rajoni, megjithatë, duhet të tregojë më shumë "gatishmëri dhe aftësi" për të zgjidhur shumë çështje themelore dypalëshe dhe të brendshme para se "BE ta marrë atë më seriozisht.”

Rekomandimet bazohen në diskutim si tërësi dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e pjesëmarrësve individualë, CIG, ose Zyrës Federale Gjermane të Jashtme, e cila mbështet nismën. Nënkryetari i CIG, Shpëtim Gashi përgatiti raportin dhe CIG merr përgjegjësinë për përmbajtjen e tij.

### Rekomandimet

1. Një vazhdim eventual i Procesit të Berlinit duhet t'u japë më shumë pronësi vendeve të Ballkanit Perëndimor, i cili nga ana e tij duhet të tregojë më shumë përkushtim dhe llogaridhënie në adresimin e mosmarrëveshjeve bilaterale dhe në rritjen e bashkëpunimit rajonal ekonomik dhe politik.
2. BE-ja dhe vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të adresojnë urgjentisht “ngurrimin” e BE-së për të përshpejtuar procesin e zgjerimit në Ballkan. Qëllimi i një “konsultimi” të tillë duhet të jetë inkurajimi i BE-së që të rigjallërojë angazhimin e saj për anëtarësim në rajon dhe që vendet e Ballkanit Perëndimor të rrisin përpjekjet e tyre për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre bilaterale, për të zbatuar reformat e brendshme demokratike dhe për të përmirësuar bashkëpunimin rajonal dhe kështu ta ofrojnë rajonin "më pranë standardeve demokratike të BE-së.”
3. Liderët e rajonit duhet të bien dakord mbi një sërë parimesh të qarta për bashkëpunim rajonal dhe për një rrugë drejt anëtarësimit në BE. Vendet e Ballkanit Perëndimor gjithashtu duhet të tregojnë më shumë lidhshmëri dhe vullnet politik për të arritur dhe zbatuar marrëveshje në nivel rajonal. Përpjekjet për të arritur marrëveshje në katër tema – heqja e vizave midis Kosovës dhe Bosnje dhe Hercegovinës, njohja e kualifikimit akademik, njohja e diplomave universitare dhe njohja e vizave për qytetarët e vendeve të treta për udhëtime nëpër rajon – brenda Procesit të Berlinit dështuan të përmbillen kryesisht për shkak të

çështjeve simbolike, kryesisht midis Prishtinës dhe Beogradit. Në të njëjtën kohë, BE -ja duhet të bëhet më e rreptë me udhëheqjet e rajonit, duke mos i lejuar ata të ndryshojnë "parimet bazë të bashkëpunimit" sa herë që u përshtaten atyre.

4. Procesi i Berlinit dhe nismat e tjera rajonale, siç është Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) me bazë në Sarajevë, nuk kanë për qëllim të zëvendësojnë procesin e zgjerimit të BE-së, por përkundrazi ta plotësojnë dhe përshejtojnë atë. BE-ja së bashku me vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të definojnë sfidat për anëtarësimin në BE dhe të punojnë më shumë me vendet anëtare skeptike të BE-së. BE-ja gjithashtu duhet të shohë nëse është e mundur të bëhet më fleksibile me disa kushte të zgjerimit, të cilat disa vende, veçanërisht Bosnja dhe Hercegovina, nuk kanë kapacitet t'i përmbushin. BE-ja gjithashtu duhet të mbajë njërin sy hapur ndaj ndikimit të aktorëve të tjerë, "jo aq dashamirës të jashtëm", të cilët po përpiqen të përfitojnë nga dobësia e perceptuar e BE-së në rajon dhe të vendosin ndikimin e tyre në këtë oborr të vogël por strategjik të Evropës. Duke pasur parasysh të gjitha këto sfida, një Proces i Berlinit më i fortë tani nevojitet më shumë se kurrë.
5. Lidshipi i BE-së nuk duhet të lejojë "çështjet e vogla dypalëshe dhe shqetësimet e dyshimta" të disa prej anëtarëve të saj të pengojnë integrimin e rajonit. BE-ja duhet të hapë negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe t'i japë liberalizimin e vizave Kosovës pa vonesa të mëtejshme. Nga ana tjetër, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk duhet të përdorin "çështje dhe justifikime të vogla dypalëshe" për të vonuar zgjidhjen e problemeve të tyre dhe për të penguar "rrugën e njëri -tjetrit drejt integritit në BE."
6. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të adresojnë frikën e BE-së për të pasur potencialisht "gjastë Orbanë të tjerë në bllokun Evropian". Transformimi demokratik në rajon duhet të jetë real. BE nuk do të mashtrohet me reformat e fasadës. BE dhe rajoni duhet të bien dakord që parimi "ju i përmushni detyrat tuaja, ne tonat" të jetë bazë e marrëdhënieve të tyre dhe rrugës së integritit dhe të dyja palët përkushtohet të angazhohen në përmbushjen e detyrave të tyre.
7. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të adresojnë shkaqet rrënjësore të mosmarrëveshjeve dhe mosbesimit të tyre.
8. BE-ja dhe vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të krijojnë një agjendë të përbashkët rajonale me objektiva dhe afate të qarta kohore. Ndoshta samitet duhet të jenë më pak ambicioze, por duhet të zhvillohen çdo tre muaj.

## **Diskutim i zgjeruar**

1. Një vazhdimësi eventuale e Procesit të Berlinit duhet t'i japë më shumë pronësi rajonit dhe ta inkurajojë atë të trajtojë sfidat e veta në mënyrë më efektive dhe efikase. Procesi shtatëvjeçar i Berlinit mbuloi një gamë të gjerë çështjesh, duke përfshirë të rinjtë, shoqërinë civile dhe mbështeti shumë aspekte të bashkëpunimit rajonal. Procesi ofroi trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në Ballkanin Perëndimor. Progres është arritur në një sërë çështjesh, por jo aq sa kishte për qëllim nisma. Vendet e Ballkanit Perëndimor u pajtuan për disa parime themelore për një treg të përbashkët rajonal, por më shumë punë duhet bërë për ta realizuar atë. Katër marrëveshjet për a) heqjen e vizave midis Kosovës dhe Bosnje dhe Hercegovinës, b) njohjen e kualifikimit akademik, c) njohjen e diplomave universitare dhe d) njohjen reciproke të vizave të lëshuara për qytetarët e vendeve të treta nuk janë ende gati për nënshkrim, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve mes Serbisë dhe Kosovës. RCC lehtësoi negociatat për këto katër çështje. Samiti i ardhshëm i tetorit në Slloveni do të mund të shtynte para nënshkrimin e këtyre katër projekt marrëveshjeve. RCC

po punon gjithashtu për krijimin e qendrave kërkimore në universitetet në rajon, por projekti është mjaft i shtrenjtë dhe mbështetja financiare nga Komisioni i BE-së duket se është e nevojshme. Kjo nismë kërkimore do të ofrojë grante për mbi 200 institucione. Cilado qoftë e ardhmja e Procesit të Berlinit, Gjermania do të vazhdojë të mbështesë rajonin dhe ta inkurajojë atë të bëhet më ambicioze në qëllimet e tij dhe më i vendosur në zbatimin e politikave publike. Modeli për vazhdimin e Procesit të Berlinit nuk është vendosur ende, por ka disa sugjerime që Komisioni i BE-së të angazhohet më shumë në rajon. Disa pjesëmarrës thane se përfshirja e SHBA do të ishte gjithashtu e dobishme.

2. BE-ja së bashku me vendet e Ballkanit duhet të adresojnë shqetësimet e BE-së për zgjerimin e mëtejshëm. Ndërkohë, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria duhet të hapin negociatat sa më shpejt që është e mundur. BE-ja duhet të bëjë më shumë për të bindur anëtarët e saj që të mos e bllokojnë procesin. BE gjithashtu mund të ndihmojë rajonin me rritjen e kapaciteteve të tij teknike. Marrëveshjet rajonale, si marrëveshja për roaming, u konsideruan se ofronin përfitime për të gjithë, por rajoni duket se nuk ka kapacitete të mjaftueshme për ta zbatuar atë në mënyrë efikase. Katër marrëveshjet e tjera kanë ngecur kryesisht për arsye politike, por edhe për çështje teknike, veçanërisht marrëveshja për vizat për qytetarët e palëve të treta. Ka shumë vullnet politik për bashkëpunim rajonal, por mosmarrëveshjet dypalëshe, si ajo mes Prishtinës dhe Beogradit, po e pengojnë procesin. Problemet midis Beogradit dhe Prishtinës në katër marrëveshjet ishin më shumë me formulime – nëse do të përdornin ‘vend’ ose ‘ekonomi’, ‘njerëz’ apo ‘qytetarë’ – sesa me përmbajtje. Për marrëveshjen e udhëtimit me letërnjoftim problemi ishte kryesisht politik ndërsa për marrëveshjen e diplomave akademike (që pritet të përfshijë nëntë profesione) ishte kryesisht teknike. Korsitë e Gjelbra është një tjetër projekt i dobishëm. Ato ishin mjaft të suksesshme për transportin e ushqimit dhe ilaçeve gjatë pandemisë. Korsitë e gjelbra duhet të funksionojnë edhe pas pandemisë. Procesi i Berlinit ndihmoi shumë komunikim në rajon dhe ofroi sinergji me iniciativat tjera rajonale si CEFTA dhe RCC. Edhe RYCO me seli në Tiranë lehtësoi komunikimin dhe bashkëpunimin mes të rinjve përmes projekteve të ndryshme rajonale dhe brenda vendit.
3. Qasja aktuale ndaj bashkëpunimit rajonal nuk është produktive sa duhet. Edhe pse ka disa probleme teknike, mungesa e bashkëpunimit është kryesisht për shkak të vullnetit të pamjaftueshëm politik. Disa shtete dhe aktorë tjerë, si bizneset dhe universitetet, mund të kenë frikë nga konkurrenca dhe lëvizshmëria, por këto shqetësime do të mund të adresoheshin së bashku. Një projekt i përbashkët rajonal mund të jetë një plan investimi që synon të tërheqë kompani të mëdha për të investuar në rajon. Procesi i Berlinit mund të ndihmojë në këtë drejtim. Rajoni besonte në Proces sepse Angela Merkel ishte prapa tij. Një lider i fortë ose një grup liderësh gjithashtu duhet të jenë prapa fazës së re të procesit. Shumë folës sugjeruan që procesi i ri të ketë një agjendë më ambicioze dhe një mekanizëm më të mirë negocimi për arritjen e marrëveshjeve.
4. Disa në Ballkanin Perëndimor kanë frikë se Procesi i Berlinit synon të zëvendësojë procesin e zgjerimit të BE-së. Dyshime e tilla duhet të sqarohen. Procesi i Berlinit synon vetëm lehtësimin e bashkëpunimit rajonal dhe përsheptimin e zgjerimit. Disa thanë se "integrimi" i rajonit në BE është i pashmangshëm. "Ne do të përfundojmë në BE në një mënyrë ose në një tjetër, ose si punëtorë ose si qytetarë të BE-së." Gjysma e qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës, për shembull, tashmë kanë pasaporta të BE-së. Rreth 30,000 njerëz largohen nga Serbia çdo vit. Numrat janë po aq të lartë në vendet e tjera të Ballkanit. Shumë folës pranuan se vendet e Ballkanit Perëndimor nuk po i bëjnë detyrat e shtëpisë, por "as BE-ja

të vetat." BE nuk po bën sa duhet për të "bindur Bullgarinë që të mos bllokojë Maqedoninë e Veriut". Një folës tha se BE duhet të bëhet më e butë me "përmbushjen e standardeve". Disa nga katërmbëdhjetë kushtet për Bosnjë dhe Hercegovinën për statusin e kandidatit janë "të pamundura për t'u përmbushur". Vonesa e integrimit ka një kosto si për Ballkanin Perëndimor ashtu edhe për BE-në, duke lejuar aktorët e tjerë të huaj të "ndërhyjnë në oborrin e shtëpisë së BE". BE-ja duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje "gjeopolitikës dhe më pak burokracisë." Disa thanë se rajoni gjithashtu duhet të mendojë se çfarë "duhet t'i ofrojë BE -së," jo vetëm "të kërkojë gjëra nga BE." BE duket se ka frikë nga "Orbanizimi i mëtejshëm i Bllokut" dhe kështu ngurron të pranojë "gjashtë Orbanë të tjerë në Bashkim." Udhëheqësit në Ballkanin Perëndimor duhet të adresojnë këtë shqetësim të BE-së.

5. BE duhet të gjejë mënyra për të bindur anëtarët e saj që të mos përdorin çështjet e tyre bilaterale për të penguar procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Përfshirja e zgjidhjes së çështjeve dypalëshe si parakusht për anëtarësimin ndoshta ishte një gabim pasi çdo anëtar mund të bllokojë një kandidat pafundësisht, duke këmbëngulur në çështje të parëndësishme apo edhe artificiale. BE duhet ta bindë Bullgarinë që t'i trajtojë çështjet dypalëshe në mënyrë më konstruktive, "pa kërcënime dhe bllokime." Përndryshe, "çështje të vogla dypalëshe mund të minojnë seriozisht angazhimin e rajonit për integrimin në BE." Mosmarrëveshja midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut duket si një "konkurrencë midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor se kush është më i pamatur." Bullgaria po e vendos Maqedoninë e Veriut në një pozitë të pamundur dhe po krijon një precedent të rrezikshëm për proceset e ardhshme të BE-së. Maqedonia e Veriut ra dakord me një propozim kompromisi portugez, por Bullgaria e refuzoi atë. Disa dyshuan se Bullgaria është duke u përdorur si "mjete" nga një vend tjetër për të bllokuar procesin e integrimit të rajonit. Një folës tha se Greqia kishte paralajmëruar Maqedoninë e Veriut vite më parë se ajo nuk është pengesa kryesore për integrimin e vendit në BE. "Janë disa të tjerë." Disa thanë se kjo po e dëmton edhe besueshmërinë e BE-së. Më mirë është që BE t'i thotë rajonit se "ne nuk duam anëtarë të rinj tani për tani" sesa të vazhdojë të përdorë "justifikime të vogla si historia dhe gjuha" për të vonuar integrimin." Procesi i BE-së po bëhet më shumë për të "kënaqur fqinjët e rajonit sesa për të ndihmuar gjashtë vendet e Ballkanit". Si e tillë ka të bëjë më shumë me çështje të vogla sesa me ato themelore. Është kryesore për BE-në të vendosë se çfarë dëshiron të bëjë me rajonin. Maqedonia e Veriut nuk mund të mbrojë pozicionin e BE-së para qytetarëve të saj për një kohë të gjatë. Shumë në Ballkanin Perëndimor e kuptojnë shqetësimin e BE -së për "më shumë orbanë në Bashkim", por atëherë BE-ja duhet të jetë e sinqertë dhe të thotë, "kjo është arsyeja kryesore për vonesën." Një politikë tjetër joproduktive e BE-së është "bërja e liberalizimit të vizave për Kosovën pjesë e dialogut Kosovë-Serbi." Dialogu mund të marrë vite dhe lidhja e liberalizimit të vizave me dialogun është "politikë e padrejtë." Vazhdimi eventual i Procesit të Berlinit duhet të fokusohet më shumë në harmonizimin e interesave dhe objektivave të rajonit sesa thjesht të "kujdeset për konfliktet në rajon".
6. Procesi i Berlinit synonte të ndihmonte në zgjidhjen e problemeve të rajonit dhe kështu të lehtësonte rrugën e tij drejt anëtarësimin të plotë në BE. Mosmarrëveshja midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut është një sprovë e madhe për BE-në. Shumë në rajon pyesin se si një "superfuqi gjigante që ndihmon në zgjidhjen edhe të çështjeve globale nuk mund ta trajtojë këtë çështje të parëndësishme të brendshme." Megjithatë BE me të drejtë ka frikë nga "gjashtë orbanë të tjerë", ajo duhet të ketë një qasje më konstruktive ndaj rajonit. BE definitivisht nuk duhet të pranojë "reformat e fasadës", por në të njëjtën kohë "nuk duhet të

bëhet partner me udhëheqësit që penguan reformat.” Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të bëjnë më shumë për të bindur BE-në se reformat e tyre janë reale dhe se ata synojnë t'i bashkohen BE -së si demokraci të vërteta. Ata mund ta bëjnë këtë duke forcuar sundimin e ligjit, duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke lejuar lirinë e mediave dhe duke zbatuar më shpejt kushtet për anëtarësimin në BE. BE dhe rajoni mund të krijojnë një mekanizëm të përbashkët për të monitoruar zbatimin e politikave të tilla. Parimi "ne i bëjmë detyrat tona, ju tuajat,” duhet të zbatohet. Maqedonia e Veriut bëri mjaftueshëm për “statusin e kandidatit” dhe tani është radha e BE-së që të përgjigjet. Kosova i plotësoi kushtet liberalizimit e vizave dhe tani është radha e BE -së për të ofruar. Një folës sugjeroi që Kosova duhet të hapë "dialog dypalësh dhe të ofrojë garanci dypalëshe" për vendet e interesuara, kryesisht Francës dhe Holandës. Një folës tha se BE do të vazhdojë të mbështesë integrimin e rajonit, por gjithashtu do të vazhdojë t'u kërkojë vendeve në rajon të bëjnë detyrat e shtëpisë "ashtu siç pritet nga një anëtar i ardhshëm i BE-së.”

7. Mosbesimi në rajon mbetet një “prishës i bashkëpunimit”. Vendet nuk i besojnë synimeve të njëra-tjetrës. Fokusi i liderëve për të fituar zgjedhje të njëpasnjëshme po i "verbon vizionet dhe përgjegjësit e tyre afatgjata për zgjidhjen e problemeve.” Liderët e Ballkanit duhet të pranojnë se vendimmarrja në BE është tashmë mjaft komplekse dhe duhet pyetur pse BE do të donte ta bënte atë edhe më komplekse me "anëtarë të rinj mosbesues.” Udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor duhet të pyesin veten se çfarë i ofron rajoni BE-së, cila është vlera e tij e shtuar. Ekonomitë e tyre janë kikirikë për BE-në. Demokracitë e tyre janë të dobëta. BE-ja nuk mund të mashtrohet. Gjëja e parë është të njohësh atë me të cilën përballlet rajoni dhe së dyti të fillosh të kërkojsh zgjidhje të qëndrueshme për problemet me të cilat përballlet. Serbia dhe Kosova duhet të përfundojnë njëherë e mirë konfliktin e tyre. Të tjerët gjithashtu duhet të gjejnë zgjidhje për çështjet e tyre bilaterale. Sapo rajoni të zgjidhë problemet e tij do të bëhet më tërheqës për BE-në.
8. BE dhe rajoni duhet të krijojnë një agjendë të përbashkët rajonale. Gjermania mund të ndihmojë shumë, pasi ajo e di më së miri nga përvoja e saj e bashkimit se çfarë duhet që një tranzicion të jetë i suksesshëm. "Kjo e bëri Gjermaninë Lindore një vend të BE-së në një kohë rekord." Agjenda e përbashkët mund të bazohet në qëllimet dhe iniciativat ekzistuese, por gjithashtu të prezantojë nisma dhe tema të reja, të tilla si sundimi i ligjit dhe korrupsioni.

## **Synimet për 2021-2024**

Lista e mëposhtme përfshin një numër arritjesh eventuale për të cilat pjesëmarrësit thanë se janë të mundshme brenda tre viteve të ardhshme.

1. Krijimi i 12,000 pozitave për praktikant në institucionet publike dhe private të ndara në mënyrë të barabartë në gjashtë vendet.
2. Bashkëpunim i plotë midis odave të tregtisë.
3. Marrëveshje për një treg të përbashkët rajonal.
4. Zbatimi i plotë i marrëveshjes roaming.
5. Një marrëveshje paqeje mes Kosovës dhe Serbisë.
6. Evente të përbashkëta të konsiderueshme rinore në një vend të ndryshëm të rajonit çdo dy muaj.
7. Lëvizja e lirë e njerëzve.
8. Krijimi i një programi Erasmus për Ballkanin Perëndimor.
9. Njohja e diplomave universitare dhe kualifikimeve të tjera profesionale.

10. Marrëveshje për korsitë e gjelbra.
11. Krijimi i një akademie gjyqësore rajonale.
12. Marrëveshje për një përkujtim të përbashkët për viktimat e luftërave të fundit në rajon dhe progres në RECOM.
13. Bashkëpunimi për reduktimin e ndotjes së ajrit.
14. Rritja e konsiderueshme e turizmit në rajon dhe krijimi i një institucioni të përbashkët rajonal kulturor dhe turistik.
15. Krijimi i një qendre rajonale të të dhënave të hapura.
16. Një strategji e përbashkët rajonale e energjisë.
17. Bashkëpunimi ekologjik.
18. Fluturime me kosto të ulët në rajon.
19. Liberalizimi i vizave për Kosovën.
20. Hapja dhe përparimi në negociatat e BE -së me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë në një rrugë të qartë drejt BE-së deri në vitin 2024.
21. Krijimi i një qendre rajonale të analizës së politikave.
22. Udhëtim pa viza midis Kosovës dhe Bosnje dhe Herzegovinës.
23. Udhëtim me letërnjoftim në rajon për banorët e tij.
24. Miratimi i një strategjie në të gjithë rajonin për të drejtat e njeriut.
25. Bashkëpunimi ndërkufitar midis komunave në Serbi dhe Kosovë.

Në përfundim, pjesëmarrësit u pajtuan se Procesi i Berlinit ndihmoi për të kuptuar kompleksitetin dhe dimensionet e sfidave të brendshme dhe të jashtme të rajonit. Së dyti, procesi ilustroi se sa i ndërvarur është rajoni, siç është rasti i Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Kjo ndërvarësi mund të funksionojë si nxitje për të punuar dhe ndihmuar njëri-tjetrin. Pjesëmarrësit pranuan rolin e rëndësishëm të BE-së dhe u pajtuan se anëtarësimi në BE nuk ka alternativë. Rajoni e kupton se çfarë duhet bërë për të zgjidhur mosmarrëveshjet rajonale. Tani është koha që rajoni të pajtohet për një listë të hapave të përbashkët për të zgjidhur problemet. Anashkalimi i tyre nuk funksionon më. Kishte konsensus se Procesi i Berlinit duhet të vazhdojë të shërbejë si një mekanizëm për të lehtësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të rajonit dhe për të ndihmuar procesin e zgjerimit të BE-së.

## Pjesëmarrësit

*Sipas rendit alfabetik anglez*

- Gresa Baftiu**, Bashkëpunore në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
- Gordana Comic**, Ish-anëtare e Parlamentit të Serbisë; Ministre për të Drejtat e Njeriut dhe Minoriteteve dhe Dialogut Social të Serbisë
- Natasa Gacesa**, Sekretare Ndërkombëtare, Partia Socialiste e Serbisë
- Shpetim Gashi**, Nënkyetar, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
- Ardian Gjini**, Nënkyetar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës; Kryetar i Gjakovës
- Albert Hani**, Sekretar Gjeneral, Zyra për Bashkëpunimin Rinor Rajonal
- Christiane Hullmann**, Udhëheqëse e Divizionit për Ballkanin Perëndimor, Departamenti Federal Gjerman për Punë të Jashtme
- Belind Kellici**, Anëtar, Presidenca, Partia Demokratike, Parlamenti i Shqipërisë
- Simonida Kordic**, Kryetar, Komiteti Kushtetues, Parlamenti i Malit të Zi; Anëtar, Presidenca, Demokracia e Re Serbe
- Mimoza Kusari Lila**, Kryetare, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Parlamenti i Kosovës
- Sasa Magazinovic**, Anëtar, Bordi Kryesor, Partia Sociale Demokratike; Anëtar, Parlamenti i Bosnje dhe Hercegovinës
- Bojan Marichikj**, Sekretar për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Bashkimi Social Demokrat i Maqedonisë; Ministër i Drejtësisë i Maqedonisë së Veriut
- Vesna Markovic**, Anëtar, Bordi Kryesor, Partia Progresive Serbe; Nënkyetar, Komisioni për Marrëdhënie me Jashtë, Parlamenti i Serbisë
- Tanja Miscevic**, Zëvendës Sekretare Gjenerale, Këshilli Rajonal për Bashkëpunim
- Shqipe Mjekiqi**, Nënkyetare, Lidhja Demokratike e Kosovës
- Igor Novakovic**, Bashkëpunor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
- Haris Plakalo**, Anëtar, Bordi Kryesor, Partia e Veprimit Demokratik; Kryetar, Lëvizja Evropiane e Bosnjës dhe Hercegovinës
- Alex Roinishvili Grigorev**, Kryetar, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
- Teuta Vodo**, Sekretare Ndërkombëtare, Partia Socialiste (Shqipëri)
- Ivan Vujovic**, Zëvendës President, Partia Social Demokrate (Mali i Zi)